V E N D I M
Nr. 591, datë 2.11.2001

PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË TEPËRT SI PASOJË E KONSERVIMIT TË TEC-IT NË QYTETIN E KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", të nenit 7 të ligjit 8718, datë 19.12.2000 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit që mbeten pa punë nga konservimi i TEC-it në qytetin e Korçës të trajtohen financiarisht për një periudhë 4-mujore, duke filluar nga data 1 shtator 2001, në masën 100 për qind të pagës mujore dhe të vjetërsisë në punë, në çastin e shkëputjes nga puna.

2. Periudha 4-mujore e pagesës për këta punonjës të njihet si vjetërsi në punë, për efekt pensioni, dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë ata punonjës që kanë qenë të punësuar në këtë ndërmarrje deri në çastin e kalimit të saj në konservim pandërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 2 vjet, e që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në formën e punësimit ose vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

4. Fondet prej 8 470 000 (tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh, të nevojshme për kryerjen e pagesës për periudhën 1 shtator - 31 dhjetor 2001, të përballohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, brenda fondeve të miratuara për vitin 2001.

5. Pagesa e punonjësve që dalin të tepërt nga zbatimi i këtij vendimi dhe e kontributeve për sigurimet e detyrueshme të bëhet nga zyrat e punësimit në rrethin e Korçës.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2001.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta